

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI B

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Sociologji

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11a	11b	12	13	14	15
Pikët								
Kërkesa	16a	16b	17	18	19	20		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Bazë e shumë besimeve fetare ka qenë ndarja e botës në: **1 pikë**
- A) e shenjtë dhe profane
 - B) shtazore dhe bimore
 - C) me zot dhe pa zot
 - D) e mirë dhe e keqe
2. Një qytet shumë i madh, që shoqërisht dhe ekonomikisht mbizotëron një zonë urbane të gjerë quhet: **1 pikë**
- A) metropol
 - B) megalopolis
 - C) xhentrifikim
 - D) eksurbanizim
3. Shtresimi shoqëror: **1 pikë**
- A) është karakteristikë e shoqërisë, pavarësisht nga vullneti i individëve të veçantë
 - B) është i përgjithshëm, por me tipare të veçanta në çdo shoqëri
 - C) vazhdon për disa breza
 - D) përmbush të tria alternativat
4. Rolin e trashëgimisë së profesioneve e gjejmë në shoqëritë: **1 pikë**
- A) tradicionale
 - B) moderne
 - C) pasmoderne
 - D) e paorganizuar
5. Realizimi i analizave krahasuese është: **1 pikë**
- A) përparësi e anketës sociologjike
 - B) mangësi e anketës sociologjike
 - C) përparësi e intervistës së lirë
 - D) mangësi e intervistës së lirë
6. Pushtimi i gjatë turk bëri që kultura shqiptare të zhvillohej si: **1 pikë**
- A) nënkulturë
 - B) more
 - C) kundërkulturë
 - D) shok kulturor
7. Modelimi i sjelljeve të fëmijëve prej prindërve të tyre, NUK ka të bëjë me: **1 pikë**
- A) formimin e personalitetit
 - B) shoqërizimin e seks-rolëve
 - C) ndryshimin e pozicioneve shoqërore
 - D) zgjedhjen e shoqërisë

8. Nofkat përçmuese janë më të dëmshme në shoqëritë: **1 pikë**
- A) me sistem lidhjesh fisnore më të forta
 - B) më të urbanizuara
 - C) e vendeve në zhvillim
 - D) multietnike
9. Cila formë e lidhjeve martesore ndihmon për ruajtjen e vlerave dhe normave kulturore tradicionale? **1 pikë**
- A) Poligamia
 - B) Ekzogamia
 - C) Monogamia
 - D) Endogamia
10. Një person që ka paragjykime personale, por nuk vepron në bazë të tyre për shkak të trysnisë së grupit ose të kërkesave të ligjit, mund të quhet: **1 pikë**
- A) paragjykues diskriminues
 - B) jodiskriminues pa paragjykime
 - C) diskriminues pa paragjykime
 - D) jo diskriminues me paragjykime
11. Analizoni interpretimin sociologjik të mënyrës së jetesës në qytete sipas Toines në:
- a) bashkësi _____ **2 pikë**

- b) shoqatë _____ **2 pikë**

12. Shpjegoni dy aspekte të lëvizjes shoqërore reformuese. **2 pikë**
- a) _____

- b) _____

13. Krahasoni konceptet: **2 pikë**
- a) pakicë etnike _____

- b) pakicë kombëtare _____

14. Përshkruani dy elemente nga zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake në shoqërinë moderne. **2 pikë**
- a) _____

- b) _____

15. Shpjegoni vëzhgimin:

3 pikë

a) sistematik _____

b) e pjesshëm _____

c) pjesëmarrës _____

16. Arsyeoni mbi ndryshimin në kulturën shqiptare të vlerave të poshtëshënuara në vitet e demokracisë:

a) fryma kolektiviste _____

2 pikë

b) barazia shoqërore _____

2 pikë

17. Shpjegoni:

3 pikë

a) devijancën parësore _____

b) devijancën dytësore _____

c) lidhjet shoqërore sipas teorisë së kontrollit _____

18. Jepni përcaktimin sociologjik të koncepteve të mëposhtëm:

3 pikë

a) shoqërizim i parashikuar _____

b) opinioni publik _____

c) personalitet _____

19. Listoni katër objektiva të tjerë të lëvizjes feministe përveç angazhimit të gjithanshëm për të rritur shkallën e barazisë ndërgjinore.

4 pikë

a) _____
b) _____
c) _____
d) _____

20. Përshkruani tre funksione kryesore të besimeve fetare, përveç përcaktimit të kuptimit të jetës. 3 pikë

a) _____
b) _____
c) _____